



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 411, datë 15.6.2022

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.79, DATË 31.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS
SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE 1, ZONA
AUTOTRAKTORI, BASHKIA TIRANË, DHE ÇAKTIMIN
E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, e të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.79, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet, si më poshtë vijon:

“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësia administrative 1, zona Autotraktori, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e shoqërisë “Tirana DC”, sh.a., si njësi zbatuese.”.

2. Në pikën 2, fjalët “... Bashkisë Tiranë ...” zëvendësohen me “... shoqërisë “Tirana DC”, sh.a., ...”.

II. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Bashkia Tiranë dhe shoqëria "Tirana DC", sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3326/I
DATË 16.6, 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
SHOQËRISË "TIRANA DC", SH.A.
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

